




DPK/DMP
02
03-3594/13
29.10.2013



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË / OSNOVNI SUD ĐAKOVICA
Divizioni i kundërvajtjes
Nr.regj.04-477/2011

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES, si gjykatë e shkallës së parë, me gjykatësen Diana Sina-Baraku, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse, kundër të pandehurës, Arsim Ali Hoxha , nga Gjakova . Për shkak të veprës kundërvajtëse nga lëmi i inspeksionit , e në bazë të nenit 73,74,195,198 al 1 pika 7 dhe neni 27 al 4 të Ligjit mbi kundërvajtjet. Me datën 23.09.2013, Gjykata mori këtë

AKTVENDIM

PEZULLOHET kërkesa për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurës , **Arsim Ali Hoxha, i lindur më 23.04.1960 , nga Gjakova Rr “M. Frasheri”, nr.67** , se është ardhur deri të parashkrimi absolut i kësaj kundërvajtje.

Konform nenit 198.al 1 pika 7 të L M K-së.

Me prurjen e këtij aktvendimi shfuqizohet aktvendimi i mëparshëm me nr.04-477/2011, te datës 28.09.2011, ne baze te nenit 217 alineja 1 te L M K.

ARSYETIM

Sipas kërkesës së Agjencisë kundër korrupsionit në Prishtinë, nr.01-3235/2011 , të datës 12.07.2011 , është filluar procedura kundërvajtëse , kundër të pandehurit, Arsim Ali Hoxha , për shkak të kundërvajtjes nga lëmi i inspeksionit.

Gjykata me rastin e shikimit te shkresave të lëndës, konstatoi se edhe pas ndërmarrjes së veprimeve nga kjo gjykatë, shihet se ka ardhur deri te parashkrimi absolut i ndjekjes më datën **23.09.2013**, për shkak se vepra kundërvajtëse është kryer më datën **12.07.2011**, në këtë rast kanë kaluar dy vite nga data kur është kryer kundërvajtja dhe për këtë arsye ka ardhur gjerë të parashkrimi absolut, andaj konform nenit 27 alineja 4 te LMK-së.

Duke u bazuar në parashtrimet e më sipërme , Gjykata konform nenit 198 alineja 1 pika 7te Ligjit mbi Kundërvajtjet. Pezullohet procedura për shkak të parashkrimit absolut.

Për sa u tha me larte u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES.

Nr.regj.04-477/2011, të datës 23.09.2013

GJYKATËSJA,
DIANA SINA- BARAKU.

03-3594/13/02
sluj

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes se këtij aktvendimi dhe këtë Gjykatës së Apelit në Prishtinë- Departamentit të përgjithshëm- Divizionit të kundërvajtjes, e nëpërmes kësaj gjykate.